



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers*

UDHËZUES I SHKURTËR PËR PROCESIN E VLERËSIMIT TË RISKUT

Hartuar në pajtim me Rregulloren (MPMS) nr. 02/2021 për vlerësimin e riskut në vendin e punës dhe praktikatat e mira; nga Leunora Zylfijaj, Udhëheqëse e Divizionit për Marrëdhënie në Punë, Dialog Social, Sigurisë dhe Shëndetit në Punë – Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve; dhe Burim Islami, Ekspert i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë.

Prishtinë, Tetor 2021

PËRMBAJTJA

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM	3
HAPAT E NEVOJSHËM PËR VLERËSIMIN DHE MENAXHIMIN E RISKUT NË VENDET E PUNËS	4
Identifikimi i rreziqeve në vendin e punës	5
Vlerësimi i riskut.....	5
Përgatitja e dokumenteve	5
Rishikimi i vlerësimit të riskut	5
1. IDENTIFIKIMI I RREZIQEVE	6
Kush është në rrezik?	7
Integrimi gjinor	7
Punëtorët e cenueshëm	7
Komunikimi me punëtorët ose përfaqësuesit e tyre	7
Mjetet që ju ndihmojnë të identifikoni rreziqet.....	8
2. VLERËSIMI I NIVELIT TË RISKUT	9
Analizimi i riskut.....	9
3. REGJISTRIMI I GJETJEVE TUAJA (PËRGATITJA E DOKUMENTIT/EVE TË VLERËSIMIT TË RISKUT)	11
4. MONITORIMI DHE RISHIKIMI/KONTROLLET (RISHIKIMI I VLERËSIMIT TË RISKUT).....	12
Monitorimi i masave të kontrollit.....	12
Rishikimi dhe përditësimi i vlerësimit të riskut	12
5. KOMUNIKIMI I VLERËSIMIT TË RISKUT.....	13
Literatura dhe praktikat e mira.....	14
Shtojca 1. Lista indikative e rreziqeve kryesore në vendin e punës	15
Shtojca 2. Shembull i vlerësimit të riskut I.....	17
Shtojca 3. Shembull i vlerësimit të riskut II	22

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Ky udhëzues synon të ndihmojë punëdhënësit, punëtorët dhe përfaqësuesit e tyre, ofruesit e jashtëm të shërbimeve të sigurisë dhe shëndetit në punë (SSHP) dhe ekspertët e SSHP-së që të bëjnë vlerësimin e riskut në vendet e punës.

Vlerësimi i riskut është vetëm një pjesë e procesit të përgjithshëm për të kontrolluar rreziqet në vendin e punës.

“Vlerësimi i riskut në vendin e punës” nënkupton një procedurë që përcakton nivelin e riskut që është kombinimi i gjasave që i punësuarit mund të lëndohet ose mund të ketë efekte shëndetësore që vijnë nga rreziqet që ekzistojnë në mjedisin e tij/saj të punës, si dhe nivelin e pasojave/ashpërsisë të mundshme të lidhura me lëndimet në punë, sëmundjet profesionale, sëmundjet që lidhen me punën dhe efekte të tjera shëndetësore.

Si punëdhënës, ju kërkohet me ligj që të mbronit punëtorët tuaj dhe të tjerët, nga aksidentet dhe sëmundjet profesionale.

Me legjislacionin në fuqi për sigurinë dhe shëndetin në punë, ([LIGJI NR. 04/L-161 PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË \(rks-gov.net\)](#)), minimumi që duhet të bëni është:

- Identifikimi se çfarë mund të shkaktojë dëmtime/lëndime ose sëmundje në biznesin tuaj (identifikimi i rreziqeve), si dhe personave (kush) që mund të dëmtohen dhe në çfarë mënyre (si);
- Identifikimi i masave ekzistuese parandaluese të ndërmarra apo zbatuara;
- Përcaktimi i gjasës/mundësisë dhe pasojës/ashpërsisë të rreziqeve;
- Marrja e masave për të eliminuar rrezikun, ose nëse kjo nuk është e mundur, atëherë duhet të bëhet shmangia, zvogëlimi/reduktimi apo zëvendësimi;
- Përcaktimi i planit të veprimit si dhe afatet kohore;
- Monitorimi dhe rishikimi.

Për shumicën e bizneseve të vogla me risk të ulët, hapat që duhet të ndërmerren janë të drejtpërdrejtë.


HAPAT E NEVOJSHËM PËR VLERËSIMIN DHE MENAXHIMIN E RISKUT NË VENDET E PUNËS

Menaxhimi i riskut është një proces hap pas hapi, për kontrollimin e riskut të shkaktuar nga rreziqet në vendin e punës.

Mund ta bëni vetë ose të caktoni një person përgjegjës (ekspert) apo ofrues të jashtëm të shërbimeve për SSHP të licencua, për t'ju ndihmuar.

Vlerësimi i riskut bëhet bazuar në [Rregulloren \(MPMS\) Nr. 02/2021 për vlerësimin e riskut në vendin e punës](#). Kjo rregullore përcakton proceset dhe procedurat, duke përfshirë identifikimin e rreziqeve lidhur me lëndimet në punë, sëmundjet profesionale, sëmundjet e lidhura me punën, si dhe identifikimin e masave të duhura parandaluese, bazuar në vlerësimin e riskut në vendin e punës. Po ashtu, rregullon mbajtjen e shënimeve dhe planin e parandalimit.

Fazat e vlerësimit riskut në vendin e punës:



*Vlerësimi i nivelit të riskut, duke përfshirë vlerësimin e masave të zbatuara dhe propozimin e masave shtesë parandaluese.

Procesi i Vlerësimit të Riskut i ndarë në disa hapa, është mënyra më e thjeshtë dhe e drejtpërdrejtë për të kryer një vlerësim nga punëdhënësi ose përfaqësues të caktuar, me përfshirjen aktive të të gjithë fuqisë punëtore.

Identifikimi i rreziqeve në vendin e punës

- Identifikimi i rreziqeve që kanë potencialin të shkaktojnë dëmtime/lëndime ose sëmundje;
- Identifikimi se kush mund të dëmtohet dhe si.

Vlerësimi i riskut

Identifikimi dhe vendosja për masat e kontrollit të riskut për sigurinë dhe shëndetin, duke përfshirë dy nën-hapa:

- Masat që tashmë janë duke u bërë në lidhje me masat ekzistuese (të zbatuara) të kontrollit të riskut;
- Masave të tjera të kontrollit të riskut që janë të nevojshme (propozimi i masave shtesë parandaluese).

Për dy nën-hapat e vlerësimit të riskut, masat e kontrollit të riskut duhet të merren parasysh dhe të përcaktohen, duke përdorur "hierarkinë e masave të kontrollit të riskut" në renditjen e mëposhtme:

- Eliminimi, shmangia, reduktimi ose zëvendësimi i rreziqeve;
- Mjetet/Veglat, pajisjet, teknologjia, inxhinieria dhe matjet që përdoren;
- Metodatat e sigurta të punës, praktikatat, organizimi, informimi dhe trajnimi;
- Higjiena dhe mirëqenia;
- Pajisjet personale mbrojtëse;
- Mbikëqyrja apo kontrollet shëndetësore/mjekësore.

Përgatitja e dokumenteve

- Regjistrimi i gjetjeve domethënëse (rreziqet, kush dhe si mund të dëmtohet, masat e ekzistuese të zbatuara dhe masat parandaluese që duhet të ndërmerren);
- Zbatimi i masave të kontrollit të riskut (duke vendosur se kush për çfarë është përgjegjës dhe deri në çfarë periudhe kohore).

Rishikimi i vlerësimit të riskut

- Monitorimi dhe rishikimi i vlerësimit të riskut. Përditësimi kur është i nevojshëm, si dhe sipas kërkesave ligjore/rregullores.

1. IDENTIFIKIMI I RREZIQEVE

Identifikimi i rrezikut çon në pranimin se rreziku ekziston dhe mund të përshkruhen karakteristikat e burimit të rrezikut; flukset e informacionit ndikojnë në identifikimin e rrezikut, si dhe rolin e ndikimit të burrave dhe grave në këto flukse informacioni. Elementi thelbësor është identifikimi i incidenteve të mëparshme, si dhe konsultimi me punëtorë të ndryshëm dhe përfaqësuesit e tyre pasi këto do të ofrojnë një sërë këndvështrimesh. Diversiteti i opinionëve do të çojë në identifikimin më të mirë të rreziqeve dhe do të reflektojë në perceptimin e situatave të njëjta nga burrat dhe gratë, si dhe ndikimin afatshkurtër dhe afatgjatë mbi to.

Për të adresuar në mënyrë efektive rreziqet në vendin e punës, së pari duhet t'i identifikoni ato siç duhet. Shikoni përreth vendit tuaj të punës dhe mendoni se çfarë mund të shkaktojë dëmtime. Ky është një nga hapat më të rëndësishëm në procesin e vlerësimit të riskut. Një rrezik që nuk identifikohet nuk mund të menaxhohet. Rrjedhimisht, është thelbësore që ky hap të jetë sa më gjithëpërfshirës. *Listën e Rreziqeve mund të gjeni në Shtojcën 1 të këtij Udhëzuesi.*

Gjatë identifikimit të rrezikut, standardi ISO 31000-2018 rekomandon që ekspertët e SSHP-së dhe palët e interesuara të shqyrtojnë edhe një larmi faktorësh, duke përfshirë:

- Burimet e prekshme dhe jomateriale;
- Kërcënimet dhe mundësitë;
- Shkaqet dhe ngjarjet;
- Pasojat dhe ndikimi i tyre në objektiva;
- Kufizimet e njohurive dhe besueshmëria e informacionit;
- Dobësitë dhe aftësitë;
- Ndryshimet në kontekstin e jashtëm dhe të brendshëm;
- Treguesit e rreziqeve të reja;
- Faktorët e lidhur me kohën;
- Paragjykimet, supozimet dhe besimet e atyre që janë përfshirë.

Duke u fokusuar në këto fusha, një ekip vlerësuesish (personat përgjegjës të SSHP-së) mund të përdorin disa metoda të ndryshme për të identifikuar rreziqet e pranishme në vendin e punës. Një metodë e tillë është identifikimi i rrezikut (HAZID - Hazard Identification) që ofron një teknikë cilësore, të strukturuar për identifikimin e rrezikut. HAZID përdor fjalë udhëzuese dhe/ose lista kontrolli për të identifikuar rreziqet e mundshme, shkaqet dhe pasojat e tyre.

Së bashku me strukturën e tij cilësore, HAZID gjithashtu mund të përfshijë analiza cilësore për të përcaktuar ashpërsinë e mundshme të një rreziku të veçantë, si dhe gjasat e shfaqjes. Ekipi i vlerësimit mund të përdorë mjete të tilla si matricat e vlerësimit të riskut dhe hartat e nxehësisë (paraqitje grafike e të dhënave të riskut ku vlerat individuale të përfshira në matricë përfaqësohen si ngjyra që nënkuptojnë sqarimin) për të krahasuar dhe përcaktuar cilat rreziqe janë me prioritet.

Këto mjete lejojnë ekspertët e SSHP-së të vendosin rreziqet në matricë ose hartë bazuar në gjasat dhe ashpërsinë e një incidenti të mundshëm. Nga këto mjete, vendimmarrësit mund të analizojnë çdo rrezik për të përcaktuar nivelin më të lartë të riskut për t'u adresuar.

Kush është në rrezik?

Sqaroni më saktësisht në çfarë shkalle në situata të ngjashme burrat dhe gratë perceptojnë dhe përjetojnë rrezikun. Edhe kur gratë dhe burrat kryejnë saktësisht të njëjtat detyra, ata përsëri mund të jenë të ekspozuar ndaj rreziqeve të ndryshme.

Integrimi gjinor

Sistemi i SSHP-së kërkon jo vetëm standardet minimale ligjore që njohin qëllimet e barazisë gjinore në sistem, por vlerësimi i riskut duhet të marrë parasysh nevojat e ndryshme dhe ndikimin te burrat dhe gratë. Çdo aktivitet certifikimi ose licencimi duhet të bazohet në kërkesat minimale për ekspertët dhe ofruesit e jashtëm të shërbimeve për SSHP që kërkojnë ndërgjegjësim, aftësi dhe shkathtësi të barazisë gjinore për të zbatuar këto kërkesa; si dhe çdo program arsimor përkatës për të përfshirë barazinë gjinore për të gjeneruar kompetencat dhe aftësitë e përcaktuara. Dallimet në formën dhe dimensionet mesatare të trupit midis sekseve nënkuptojnë që pajisjet dhe mjetet e punës të dizajnuara për trupat e burrave, janë shpesh të papërshtatshme për gratë. Për shembull, veglat e dorës dhe lartësitë e vendeve të punës, janë shpesh të parrhatshme për punëtorët që janë më të vegjël ose më të gjatë dhe më të mëdhenj se punëtorët "standard".

Punëtorët e cenueshëm

Disa punëtorë kanë kërkesa të veçanta, për shembull:

- Gratë;
- Gratë shtatzëna dhe gratë gjidhënëse;
- Të punësuarit në moshë të re;
- Të punësuarit në moshë të vjetër;
- Të punësuarit me aftësi të kufizuara;
- Të punësuarit me sëmundje ekzistuese, etj.

Komunikimi me punëtorët ose përfaqësuesit e tyre

Flisni me punëtorët ose përfaqësuesit e punëtorëve, përfshini në proces pasi ata zakonisht do të kenë ide të mira. Punëdhënësi, eksperti i SSHP-së ose ofruesi i jashtëm i shërbimeve për SSHP, gjatë identifikimit të rreziqeve duhet të bazohet në praktikën e mira dhe të ketë parasysh pikat në vijim:

- Ecnë nëpër vendin tuaj të punës dhe shikoni se nga çfarë mund të pritët që të shkaktohen dëme;

- Identifikoni cilat aktivitete dhe procese të punës janë më të rrezikshmet, dhe në cilat pjesë të vendit të punës (mund të jetë e dobishme përdorimi i një liste kontrolli; në çdo rast, është e rëndësishme të mbani shënime për të mundësuar hartimin e vlerësimi të riskut përfundimtar);
- Pyetni punëtorët, ose përfaqësuesit e tyre, se çfarë mendojnë ata për rreziqet lidhur me punët që ata e kryejnë, dhe si mund të parandalojnë aksidentet dhe sëmundjet në vendin e punës. Ata mund të kenë vërejtur gjëra që nuk janë menjëherë të dukshme për ekspertët ose për një ofruar të jashtëm të shërbimeve për SSHP;
- Mësoni nga përvoja e aksidenteve të mëparshme dhe rasteve të përkeqësimit të shëndetit, meqenëse ndihmojnë shpesh në identifikimin e rreziqeve më pak të dukshme;
- Mos harroni të mendoni për rreziqet afatgjata ndaj shëndetit (p.sh. nivelet e larta të zhurmës, mikroklima, ose ekspozimi ndaj substancave të dëmshme), si dhe rreziqet e tjera të sigurisë;
- Pyesni punëtorët tuaj nëse mund të tregojnë për ndonjë rrezik që ju nuk e keni identifikuar, ose ndonjë ngjarje që punëtorët kanë qenë në rrezik potencial;
- Kontrolloni udhëzimet e prodhuesve ose fletët e të dhënave të sigurisë për kimikatet dhe pajisjet, pasi mund të jenë shumë të dobishme në identifikimin e rreziqeve dhe vendosjen e tyre në perspektivën e tyre të vërtetë.

Mjetet që ju ndihmojnë të identifikoni rreziqet

- Përdorni listat e kontrollit (të përgjithshme ose sipas sektorit specifik);
- Inspektimet ose anketat/pyetësorët e mëparshëm në vendin e punës;
- Raportet e shkruara ose verbale të rreziqeve/aksidenteve;
- Vëzhgimet personale;
- Komiteti i sigurisë dhe shëndetit, nëse ekziston një i tillë;
- Etiketat ose shenjat paralajmëruese;
- Fletët e të dhënave të sigurisë nga prodhuesit;
- Raportet e konsulentëve, etj.

Për secilin rrezik që keni identifikuar, edhe nëse mund të ketë shumë të tilla, duhet të jeni të qartë se kush mund të dëmtohet dhe si. Kjo nënkupton identifikimin e grupeve të punëtorëve tuaj, dhe të tjerëve siç është publiku (pala e tretë), të cilët janë të rrezikuar nga ekspozimi ndaj rreziqeve, se në çfarë mënyre janë ata në rrezik, si dhe pasojat potencialisht negative për sigurinë dhe shëndetin e tyre.

2. VLERËSIMI I NIVELIT TË RISKUT

Pasi të keni identifikuar rreziqet, përcaktoni gjasën/mundësinë që dikush mund të dëmtohet dhe sa serioz mund të jetë dëmtimi (pasojën/ashpërsinë).

Analizimi i riskut

Duke punuar me informacionin e mbledhur gjatë identifikimit të rreziqeve, ekipi vlerësues pastaj mund të fillojë të analizojë nivelet e caktuara të riskut dhe të ju japë përparësi veprimeve bazuar në kontrollet ekzistuese, mes kritereve të tjera.

Analiza e riskut përfshinë një shqyrtim të hollësishëm të pasigurive, rreziqeve, gjasave, pasojave, ngjarjeve, skenarëve, kontrolleve dhe efektivitetit të tyre. Një ngjarje mund të ketë shkaqe dhe pasoja të shumta, si dhe mund të ndikojë në shumë objektiva të punëdhënësit. Rreziqet e identifikuar më parë me HAZID mund të përfshihen në analizën paraprake të riskut. Në një analizë të tillë, një vlerësues analizon kushtet aktuale me kontrollet ekzistuese dhe një gjendje të mundshme të ardhshme me kontrolle shtesë të propozuara. Mjete të tilla si matricat e vlerësimit të riskut dhe hartat, mund të përdoren për të krahasuar dhe përcaktuar cilat rreziqe janë me prioritet. Rezultatet nga një analizë paraprake e riskut mund të barten në një qasje më të detajuar, siç është diagrami i vlerësimit të riskut për vlerësim të mëtejshëm për të siguruar informacion më të thelluar për vendimmarrësit.

Për sa i përket gjetjes së zgjidhjeve të pranueshme për një rrezik të veçantë, analiza e nivelit të mbrotjes (LOPA – Layer of Protection Analysis), studion nëse barrierat ekzistuese ose të propozuara janë në gjendje të arrijnë nivele të pranueshme të rrezikut. Gjatë kryerjes së një LOPA, ekspertët e SSHP-së zgjedhin rreziqet dhe pasojat, si dhe nivelet e pavarura të mbrotjes (IPL – Independent Protection Layer). IPL-të janë barrierat fizike siç janë kontrollet inxhinierike, ndryshimet e projektimit ose pajisjet paralajmëruese të krijuara për të parandaluar që shkakut inicues të vazhdojë në pasojat e padëshiruara. Aplikimi i këtij lloji të qasjes ndaj analizës së riskut i lejon ekspertët të marrin në konsideratë se çfarë IPL shtesë mund të instalohen për të parandaluar një rrezik të veçantë, si dhe të llogarisin ndikimin që ato kontrolle do të kishin në ashpërsinë dhe gjasat e një incidenti.

Vlerësimi i riskut u bën thirrje ekspertëve të SSHP-së që të shqyrtojnë rezultatet e analizës së riskut dhe t'i krahasojnë ato me kriteret e përcaktuara në mënyrë që të përcaktojnë se ku mund të kërkohen kontrolle shtesë dhe cilat mund të jenë ato kontrolle. Analiza e riskut përqendrohet rreth një incidenti/aksidentit të mundshëm, duke shqyrtuar shkaqet e tij, kontrollet parandaluese të zbatuara, kontrollet lehtësuese nëse do të ndodhte dhe pasojat e incidentit/aksidentit.

Pavarësisht nga metoda, mbani në mend se vendimmarrja e bazuar në risk duhet të marrë parasysh kontekstin më të gjerë, si dhe pasojat aktuale dhe të perceptuara për palët e brendshme dhe jashtme.

Mendo për:

- Si punojnë punëtorët, përdoren makineritë dhe pajisjet?
- Çfarë kimikatesh dhe substancash përdoren?
- Cilat praktika të sigurta ose të pasigurta të punës ekzistojnë?
- Gjendjen e përgjithshme të ambienteve të punës;
- Shikoni përsëri aksidentet e ndodhura dhe të dhënat shëndetësore të punëtorëve, pasi këto mund t'ju ndihmojnë të identifikoni rreziqe më pak të dukshme;
- Merrni parasysh operimet jo-rutinore, të tilla si mirëmbajtja, pastrimi ose ndryshimet në ciklet e prodhimit;
- Mendoni për rreziqet e shëndetit, të tilla si trajtimi manual, përdorimi i kimikateve dhe shkaqet e stresit lidhur me punën;
- Për secilin rreziq, mendoni se si punëtorët, kontraktorët dhe vizitorët (palët e treta) mund të lëndohen.

Përcaktoni:

- Çfarë masa keni ndërmarrë tashmë?
- Çfarë veprimesh të mëtejshme duhet të ndërmerrni?
- Kush duhet të kryejë veprimin?
- Kur veprimi është i nevojshëm, si dhe deri në çfarë periudhe kohore duhet të përfundojë?

Pyesni veten:

- A mund të eliminohet krejtësisht rreziku?
- Nëse jo, si mund t'i kontrollohet në mënyrë që dëmi të mos ketë gjasa të ndodhë duke shmangur, reduktuar apo zëvendësuar?

Nëse keni nevojë për kontrole të mëtejshme, merrni parasysh:

- Ridizajnimin e punës;
- Zëvendësimin e materialeve, makinerive ose procesit;
- Organizimin e punës për të zvogëluar/reduktuar ekspozimin ndaj materialeve, makinerive ose procesit;
- Largimin e punëtorëve nga rreziku (për shembull, zëvendësimi i sistemit aktual me një sistem tjetër të automatizuar);
- Izolimimin e rreziqeve (për shembull, mbyllini/rrethoni pjesët e rrezikshme me barriera);
- Aplikimin e strategjive të përshtatshme të menaxhimit;
- Identifikimin dhe zbatimin e masave praktike të nevojshme për të punuar në mënyrë të sigurt;
- Sigurimin e pajisjeve personale mbrojtëse;
- Informimin dhe trajnimin e punëtorëve.
- Zbatimin e metodave të sigurta të punës dhe praktikave të mira

- Higjienën dhe mirëqenien;
- Mbikëqyrjen apo kontrollet shëndetësore/mjekësore.

Nuk pritet të eliminohen rreziqet, por duhet të bëhet gjithçka në mënyrë të arsyeshme dhe të zbatueshme për t'i mbrojtur njerëzit nga dëmtimet. Kjo nënkupton balancimin e nivelit të riskut kundrejt masave të nevojshme për të kontrolluar. Mund të gjeni udhëzime më të hollësishme mbi kontrollet që lidhen me biznesin tuaj.

3. REGJISTRIMI I GJETJEVE TUAJA (PËRGATITJA E DOKUMENTIT/EVE TË VLERËSIMIT TË RISKUT)

Duhet të regjistroni gjetjet tuaja domethënëse, duke përfshirë:

- Rreziqet (që mund të shkaktojnë dëme);
- Kush mund të dëmtohet dhe si?
- Çfarë masa keni ndërmarrë tashmë (masat ekzistuese – të zbatuara)?
- Çfarë veprimesh të mëtejshme duhet të ndërmerri (propozimin e masave shtesë parandaluese)?
- Kush duhet të kryejë veprimin?
- Kur veprimi është i nevojshëm, si dhe deri në çfarë periudhe kohore duhet të përfundojë?

Pra, vlerësimi me shkrim i riskut duhet të jetë praktik, si dhe gjithëpërfshirës. Duhet të tregojë se:

- Një hetim i duhur është bërë/ndërmarrë;
- Rreziqet janë identifikuar dhe adresuar, duke marrë parasysh numrin dhe gjendjen e ekspozimit ndaj mundësisë për t'u sulmuar ose dëmtuar (fizikisht apo emocionalisht, sëmundjet profesionale apo që lidhen me punën, si dhe efekte të tjera shëndetësore) të personave/punëtorëve që mund të përfshihen;
- Masat parandaluese janë të arsyeshme.

Dokumenti i vlerësimit të riskut është mjet i dobishëm për punëdhënësit, mbikëqyrësit, punëtorët dhe përfaqësuesit e tyre, si dhe duhet të mbahet për përdorim në të ardhmen. Mund të përdoret si mjet referimi, për t'u kujtuar të gjithëve që të jenë të vetëdijshëm për rreziqet e veçanta dhe masat e nevojshme parandaluese që duhet të ndërmerren për të zvogëluar/reduktuar nivelin e riskut.

Vlerësimi i riskut, ashtu siç është theksuar, është kërkesë ligjore dhe kërkohet nga Inspektorët e Punës, që të shikojnë dhe analizojnë që punëdhënësi po i përmbush detyrat/obligimet për të siguruar një mjedis pune të sigurt dhe të shëndetshëm në përputhje me Ligjin.

4. MONITORIMI DHE RISHIKIMI/KONTROLLET (RISHIKIMI I VLERËSIMIT TË RISKUT)

Monitorimi i masave të kontrollit

Monitorimi dhe kontrollimi efektiv i masave të kontrollit të riskut, si dhe të sigurohet që ato të mirëmbahen.

Rishikimi dhe përditësimi i vlerësimit të riskut

Nuk është një aktivitet që bëhet vetëm një herë. Ju duhet të rishikoni kontrollet që keni vendosur për t'u siguruar që ato po funksionojnë, si dhe bazuar në Rregulloren MPMS 02/2021 vlerësimi i riskut në vendin e punës duhet të rishikohet jo më pak se një herë në dy (2) vite.

Ju gjithashtu duhet të rishikoni vlerësimin e riskut nëse:

- Masat e ndërmarra nuk janë efektive;
- Fillon praktikisht një lloj tjetër aktiviteti, është shtuar një aktivitet i ri;
- Ka ndryshime në vendin e punës që mund të çojnë në rreziqe të reja, siç janë ndryshimet në:
 - Staf;
 - Procese dhe procedura të punës;
 - Metodat, pajisjet, mjetet/veglat, organizimin e punës, higjienën, pajisjet personale mbrojtëse;
 - Përdorimin e substancave të ndryshme;
 - Vendi i punës ka pësuar modifikime thelbësore;
- Nga Inspektorati i Punës identifikohen shkeljet e sigurisë në punë dhe akteve ligjore (brenda dy javësh pas marrjes së dokumentacionit nga Inspektorati i Punës);
- Ka ndodhur një aksident, incident apo aksident i shpëtuar (near miss) në punë, rishikimi duhet të përsëritet brenda dy javësh pas aksidentit, vetëm për vendet e punës ose proceset e punës të përfshira;
- Është regjistruar një sëmundje profesionale (brenda dy javësh pas regjistrimit të sëmundjeve profesionale, vetëm për vendet e punës ose proceset e punës të përfshira);
- Në rastet kur zhvillohen akte të reja ligjore në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, këto akte ligjore duhet të merren parasysh gjatë kryerjes së vlerësimit të riskut në vendin e punës, por jo më vonë se pas një viti.

Konsideroni gjithashtu një rishikim nëse punëtorët tuaj kanë vërejtur ndonjë problem ose ka ndodhur ndonjë ngjarje me mundësi lëndimi/dëmtimi gjatë procesit të punës.

5. KOMUNIKIMI I VLERËSIMIT TË RISKUT

I ndërlidhur në të gjitha hapat e procesit të vlerësimit të riskut, është një element tjetër po aq vendimtar për menaxhimin efektiv – *Komunikimi i dokumentit të vlerësimit të riskut.*

Ekspertët e SSHP-së duhet të kenë parasysh se ata duhet të komunikojnë rreziqet e identifikuara, të analizuara dhe të vlerësuara gjatë vlerësimit për të gjitha palët e përfshira, në mënyrë që të gjithë të kenë një kuptim gjithëpërfshirës të rreziqeve ekzistuese dhe se si ato mund të parandalohen më së miri për të arritur objektivat organizative.

Marrja e hapave të përshkruara në këtë udhëzues, ju mundëson të gjitha palëve të përfshira të kenë një kuptim të hollësishëm të rreziqeve që ekzistojnë brenda objekteve dhe proceseve, pasojat e rreziqeve të pranishme dhe se si ato mund të parandalohen ose zvogëlohen për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve.

Më poshtë, si shtojca të udhëzuesit, janë paraqitur shkurtimisht disa shembuj nga praktikat e mira.

Literatura dhe praktikat e mira

- Udhëzues për vlerësimin e riskut nga ILO (International Labour Organization – <https://www.ilo.org/global/lang--en/index.htm>)
 - Paketa trajnuese mbi Vlerësimin dhe Menaxhimin e Riskut në vendin e punës, për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme; linku: https://www.ilo.org/safework/info/instr/WCMS_215344/lang--en/index.htm
 - Video nga ILO për sigurinë dhe shëndetin në industrinë e drurit (rreziqet, masat parandaluese, etj.), linku i videos në youtube: <https://www.youtube.com/watch?v=ZeF6kfm4nIA&t=18s>
 - Video e vlerësimit të riskut sipas OiRA (web: <https://oiraproject.eu/en> dhe <https://osha.europa.eu/en>, linku i videos në youtube: <https://www.youtube.com/watch?v=IU2DWX1DzFY>)
 - Video e AECOM SH&E Training and Development për vlerësimin e riskut, linku i videos në youtube: <https://www.youtube.com/watch?v=bPqPuWSFSm8>
 - Video e NEBOSH IG2 Risk Assessment (IGC New Syllabus) për vlerësimin e riskut, linku i videos në youtube: <https://www.youtube.com/watch?v=9JWeLwhmdSY>
- Referencat:
- <https://www.nebosh.org.uk/home/>
 - <https://osha.europa.eu/en>
 - <https://oiraproject.eu/en>
 - <https://www.ilo.org/global/lang--en/index.htm>
 - <https://ip.rks-gov.net/>
 - <https://mpms.rks-gov.net/>
 - <https://gzk.rks-gov.net/>
 - [LIGJI NR. 04/L-161 PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË \(rks-gov.net\)](#)
 - [Rregulloren \(MPMS\) Nr. 02/2021 për vlerësimin e riskut në vendin e punës](#)

Shtojca 1. Lista indikative e rreziqeve kryesore në vendin e punës

Rreziqet traumatike	
1	Sipërfaqe të pabarabarta ose të rrëshqitshme (të cilat mund të shkaktojnë rrëshqitje, pengesa, rënie etj.)
2	Automjete lëvizëse (pirunë, kamionë, etj.)
3	Pjesë lëvizëse mekanike të makinerive (p.sh. sistemet e konvejerëve)
4	Objekte dhe pjesë me sipërfaqe të rrezikshme (të mprehtë, të ashpër, etj.)
5	Sipërfaqe, materiale të nxehta ose të ftohta, etj. (p.sh. furra dhe boilerë)
6	Puna në lartësi
7	Puna në shkallë
8	Objekte që bien
9	Vegla dore (me dhe pa rrymë)
10	Siguria elektrike (instalimet dhe pajisjet elektrike, tokëzimi dhe rrufepritësi)
11	Siguria nga zjarri
12	Shpërthimi
13	Puna në hapësira të mbyllura
14	Puna në gërmime
15	Stabiliteti i sipërfaqes
16	Hapjet në sipërfaqe dhe mure
17	Pastërtia, rregulli në vendin e punës
Rreziqet fizike	
18	Zhurma
19	Dridhje
20	Ndriçimi
21	Mikroklima e brendshme
22	Klima e nxehtë ose e ftohtë (puna jashtë)
23	Rrezatimi UV, IR, lazer dhe mikrovalë, rrezatimi jo-jonizues
24	Rrezatimi jonizues
25	Shtypje e lartë

Rreziqet nga kimikatet dhe pluhuri	
26	Substanca kimike dhe materiale të rrezikshme
27	Pluhuri
28	Korrozioni (ndryshku)
29	Asbest
30	Kancerogjen, mutagjen
Rreziqet psiko-sociale	
31	Ngarkesa, mbingarkesa, shterimi fizik dhe mendor
32	Organizim i pamjaftueshëm i punës dhe komunikim i pamjaftueshëm me menaxhmentin dhe kolegët
33	Dhuna, ngacmimi (mobbing/bulling)
34	Puna i vetëm
35	Puna me palë (klientë, konsumatorë etj.)
36	Orari i punës, puna jashtë orarit, mungesa e kohës, menaxhimi i kohës
37	Puna në ndërrime, përfshirë ndërrimet e natës
38	Rreziqe të tjera që çojnë në stres në punë (p.sh ndryshimet e shpejta në procedurat e punës, situatat konfliktuoze, përcjellja në vazhdimësi e inovacioneve dhe aplikimi i tyre në praktikë, puna me të holla, përgjegjësia gjatë punëve të ndërlikuara ku nevojitet marrja e vendimeve të shpejta).
Rreziqet ergonomike	
39	Ngritja dhe mbajtja e ngarkesave
40	Puna që përfshin pozicion të dobët (pozicion të papërshtatshëm), lëvizje përsëritëse, shtrirje të zgjatur
41	Puna me ekrane
42	Mbingarkesa e zërit
43	Rreziqet biologjike
44	Viruse, parazitë, myk, baktere
45	Kafshë, gjarpërinj etj.
46	Kontakti me insektet

Shtojca 2. Shembull i vlerësimit të riskut I

SHEMBULL I VLERËSIMIT TË RISKUT

Ndërmarrja:

Sektori/Njësia:

Data:

HAPI 1:	HAPI 2:	HAPI 3:	HAPI 4:												
Cilat janë rreziqet?	Kush mund të dëmtohet dhe si?	Çfarë jeni duke bërë tashmë?	Çfarë veprime të mëtutjeshme janë të nevojshme?												
<p>Vëreni rreziqet duke:</p> <ul style="list-style-type: none"> Ecur përreth vendit të punës; Pyetur punëtorët se çfarë ka ndodhur; Kontrolluar udhëzimet e prodhuesve; Kontaktuar përfaqësuesin e punëtorëve. <p>Mos harroni rreziqet afatgjata.</p>	<p>Identifikoni grupet e njerëzve. Mbani në mend:</p> <ul style="list-style-type: none"> Disa punëtorë kanë nevoja të veçanta; Jo çdoherë mund të jenë të gjithë në vendin e punës në çdo kohë; Nëse e ndani vendin e punës me dikë, mendoni se si puna juaj mund t'i afektojë të tjerët; Anëtarët e publikut. <p>Tregoni si mund të shkaktojë dëm rreziku.</p>	<p>Listoni çfarë është tashmë në zbatim për të reduktuar gjasën e dëmtimit apo për ta bërë dëmtimin më pak serioz</p>	<p>Ju duhet të siguroheni që i keni reduktuar risqet "aq sa është praktikisht e mundshme". Një mënyrë e lehtë për të bërë këtë gjë është të krahasohet çfarë jeni tashmë duke bërë me praktikën më të mirë. Nëse ka dallime, listoni se çfarë duhet të bëhet.</p>												
			<p>Si do ta vëni në veprim vlerësimin tuaj?</p> <p>Mos harroni të jepni përparësi. Trajtoni së pari rreziqet të cilat kanë risk të lartë dhe pasoja serioze.</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Veprimi nga kush</th> <th>Veprimi deri kur</th> <th>Data</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Veprimi nga kush	Veprimi deri kur	Data									
Veprimi nga kush	Veprimi deri kur	Data													

HAPI 5:

Data e rishikimit:

Rishikoni vlerësimin tuaj për tu siguruar që jeni duke bërë përmirësime.

Nëse ka ndonjë ndryshim të madh në vendin tuaj të punës, mos harroni të kontrolloni vlerësimin e riskut dhe kur është e nevojshme ta përditësoni atë.

Vlerësimi është bërë nga:

(nënshkrimi)

Përdorimi i matricës 3x3

Shumica e bizneseve të vogla mund të mos kenë nevojë të përdorin matricën gjatë vlerësimit të riskut. Sidoqoftë një vegël e tillë mund të përdoret për të përcaktuar nivelin e riskut në lidhje me një çështje të caktuar. Matrica e riskut një gjë e tillë e bënë nëpërmjet kategorizimit të dëmit dhe ashpërsinë potenciale të dëmit. Niveli i riskut përcakton cilat rreziqe duhet të trajtohen së pari, duke filluar me atë më të lartë.

Matrica e dhënë në vijim është e tipit 3x3.

ASHPËRSIA APO PASOJA E NJË NGJARJEJE				
PROBABILITETI (GJASA/MUNDËSIA) QË TË NDODHË NGJARJA		Lehtësisht e dëmshme	Mesatarisht e dëmshme	Shumë e dëmshme
	E ulët	Risk i ulët	Risk i ulët	Risk mesatar
	E mundshme	Risk i ulët	Risk mesatar	Risk i lartë
	Shumë e mundshme	Risk mesatar	Risk i lartë	Risk i lartë

Referenca: *Udhëzues për vlerësimin e riskut nga ILO (International Labour Organization). Paketa trajnuese mbi Vlerësimin dhe Menaxhimin e Riskut në vendin e punës, për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*

SHEMBULL I VLERËSIMIT TË RISKUT (Riparimi i motorëve të automjeteve)

Ndërmarrja: XY

Sektori/njësia: Riparimi i motorëve të automjeteve (vetëm riparimet mekanike)

Data: xx/xx/2021

HAPI 1:	HAPI 2:	HAPI 3:	Hapi 4:			
Cilat janë rreziqet?	Kush mund të dëmtohet dhe si?	Çfarë jeni duke bërë tashmë?	Çfarë veprime të mëtotjeshme janë të nevojshme?	Veprimi nga kush	Veprimi deri kur	Data
Kontakti i substancave të rrezikshme në vajin e përdorur të motorrit.	Punëtorët, si rezultat i kontaktit të lëkurës për një periudhë të gjatë mund të vuajnë nga dermatiti i rëndë apo kanceri i lëkurës.	<ul style="list-style-type: none"> Furnizimi me dorëza nitrile dhe përdorimi i tyre. Furnizimi me rroba për tërë trupin dhe përdorimi i tyre Pastrim i rregullt i rrobave. 	<ul style="list-style-type: none"> Të bëhet kontrollë nga mbikëqyrësi për përdorimin e dorëzave. Të ju shpjegohen punëtorëve rreziqet nga dermatiti dhe kanceri në lëkurë. 	XY	xx/xx/xxx	xx/xx/xxx
Tymrat toksike që lirohen nga veturat kur janë ndezur p.sh monoksidi i karbonit.	Tymi mund të ju shkaktoj punëtorëve irrim të syve dhe vështirësi në frymëmarrje.	<ul style="list-style-type: none"> Sigurimi që veturat janë të ndezura vetëm në hapësira të ventiluara. 	<ul style="list-style-type: none"> Të identifikohet nga menaxhmenti mundësia e përdorimit të një sistemi ekstraktues që vendoset mbi makinë gjersa ajo është e ndezur. 	XY	xx/xx/xxx	xx/xx/xxx
Mbushja e baterive.	Punëtorët mund të pësojnë të djegura nga kontakti me acidin e baterisë gjatë mbushjes, veçanërisht nëse bateria është e tejmbushur dhe shpërthen.	<ul style="list-style-type: none"> Karikatori i duhur, i instaluar nga elektrikisti dhe përdoret sipas udhëzimeve. Furnizimi me dorëza dhe syze rezistente ndaj acideve. 	<ul style="list-style-type: none"> Nuk ka nevojë. 	XY	xx/xx/xxx	xx/xx/xxx
Pajisjet elektrike Pajisjet fikse dhe ato portative	Të gjithë punëtorët potencialisht mund të pësojnë goditje elektrike apo djegie nëse i përdorin pajisjet elektrike me defekte (pajisjet portative janë më të pritura të dëmtohen). Pajisjet e dëmtuara me defekte mund të shkaktojnë edhe zjarre.	<ul style="list-style-type: none"> Bateritë e dorës etj. Janë të tensionit të ulët (24 volt) Pak pajisje deri në 230 volt që përdoren të gjitha i kanë kabllot kyçese dhe spinat industriale. Bëhet inspektim vjetor i të gjitha pajisjeve portative 24 V dhe përdoruesit trajnohen për kontrollimin vizual të tyre dhe raportimin e defekteve. Pajisjet e instaluar mirëmbahen rregullisht. 	<ul style="list-style-type: none"> Të shqyrtohet nga menaxhmenti mundësia e zëvendësimit të pajisjeve me pajisje alternative. 	XY	xx/xx/xxx	xx/xx/xxx

Trajtimi manual i ngarkesave	Të gjithë punëtorët (veçanërisht ata që punojnë në depo) mund të vuajnë nga dhimbjet e shpinës nëse rregullisht mbajnë ose lëvizin objekte të rënda apo të papërshtatshme.	<ul style="list-style-type: none"> • Përdorimi i pirunarit për të bartur materialin në depo dhe në punëtoritë përkatëse. • Përdorimi i mjeteve tjera ndihmëse për trajtim manual të ngarkesave si p.sh. karrocet etj. 	• Ofrimi i trajnimit për trajtim manual të ngarkesave për të gjithë punëtorët (veçanërisht të depove).	XY	xx/xx/xxx	xx/xx/xxx
Rrëshqitjet dhe rëniet	Nëse punëtorët rrëzohen nga lartësia, rrëshqasin nga platformat ngritëse etj. Mund të pësojnë lëndime si p.sh thyerje të gjymtyrëve.	<ul style="list-style-type: none"> • Standarde të mira të mirëmbajtjes së hapësirave nëpërmjet trajnimit dhe monitorimit. • Pastrimi i rregullt i dyshemeve. • Mirëmbajtja e hyrjeve dhe daljeve të objekteve. 	<ul style="list-style-type: none"> • Shejzimi i rrugëve për ecje. • Të fillohet kontrollimi javor i mirëmbajtjes së objekteve. 	XY	xx/xx/xxx	xx/xx/xxx
Operimi me pirunar	Lëndime si frakturat mund të shkaktohen nga: <ul style="list-style-type: none"> • Aksidenti me automjet nga shoferi. • Punëtorët dhe vizitorët mund të goditen nga pirunari. • Rrëzimi i punëtorëve nga pirunari • Rënia e objekteve nga pirunari. • Rrotullimi i pirunarit. 	<ul style="list-style-type: none"> • Të gjithë operatorët janë të trajnuar dhe kompetent për përdorimin e pirunarit. • Automjeti servisohet rregullisht dhe kryhen kontrollimet teknike çdo 6 muaj. • Mirëmbajtja e rregullt e dyshemesë. 	• Të organizohet një trajnim rifresukes për të gjithë operatorët.	XY	xx/xx/xxx	xx/xx/xxx
Lëvizja e automjeteve	Lëndime si frakturat mund të shkaktohen nëse punëtorët apo konsumatorët goditen nga vizitorët.	<ul style="list-style-type: none"> • Ofrimi i parkingut të sigurt për konsumatorët. • Shenjëzimi i vendkalimeve për këmbësorë. • Automjetet voziten ngadalë gjatë hyrjes/daljes dhe përreth hapësirave të punës. 	• Monitorimi për respektimin e kufizimit të shpejtësisë nga ana e mbikëqyrësve.	XY	xx/xx/xxx	xx/xx/xxx

Rreziku i përgjithshëm nga zjarri	Mund të shkaktohet djegia e ndërtesave. Punëtorët mund të pësojnë djegie fatale apo të rënda.	<ul style="list-style-type: none"> • Pirja e duhanit është e ndaluar në të gjitha zonat. • Alarmet e zjarrit mirëmbahen dhe testohen rregullisht. • Aparatet për fikjen e zjarrit janë të qasshëm dhe mirëmbahen rregullisht. • Daljet emergjente janë të lira dhe pa pengesa. • Derdhjet e karburanteve pastrohen menjëherë. 	<ul style="list-style-type: none"> • Të ofrohet trajnim për mbrojtjen kundër zjarrit. • Të ju shpjegohen punëtorëve mënyrat e sigurta të punës me lëndë djegëse siç janë karburantet e automjeteve. 	XY	xx/xx/xxx	xx/xx/xxx
-----------------------------------	-----------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	----	-----------	-----------

HAPI 5:

Data e rishikimit:

Vlerësimi është bërë nga:

(nënshkrimi)

Referenca: Udhëzues për vlerësimin e riskut nga ILO (International Labour Organization). Paketa trajnuese mbi Vlerësimin dhe Menaxhimin e Riskut në vendin e punës, për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Shtojca 3. Shembull i vlerësimit të riskut II

Vlerësimi i riskut në vendin e punës është një prej mekanizmave kryesor për sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë. Procedura e vlerësimit të riskut duhet të zhvillohet në pajtim me Ligjin Nr. 04/ L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Në vijim është paraqitur vlerësimi i riskut duke e përdorur metodologjinë e Matricës 5x5, e cila mund të përdoret në kombinim me metoda të tjera. Kjo metodë e analizon marrëdhënien ndërmjet dy variablave duke vlerësuar kështu ndërlidhjen ndërmjet gjasës dhe ashpërsisë (shkak-pasojë).

Përkufizime të rëndësishme:

Rrezik: Çdo situatë apo gjendje e cila ka potencial për të shkaktuar dëmtim apo lëndim.

Risk (R): Është një kombinim i gjasës/probabilitetit (L - likelihood) që dikush mund të dëmtohet ose që të mund të shkaktohet një dëm tjetër nga rreziku dhe i ashpërsisë/pasojës (S – severity) të këtij dëmtimi ($R=L \times S$).

Gjasa/ Probabiliteti (L - likelihood): Është niveli i probabilitetit që diçka mund të ndodhë.

Ashpërsia/Pasoja (S – severity): Përshkruan nivelin më të lartë të dëmit të mundshëm kur ndodhë një aksident si pasojë e një rreziku të caktuar.

Vlerësimi i riskut: Është procedurë e cila përcakton nivelin e riskut në lidhje me një lëndim në punë, sëmundje profesionale, sëmundje lidhur me punën dhe çrregullime të lidhura me procesin e punës që mund të shkaktojnë efekte të dëmshme tek shëndeti dhe siguria e punëtorëve. Vlerësimi i riskut bazohet në evidentimin sistematik dhe vlerësimin e të gjithë faktorëve të procesit të punës, në mënyrë që të përcaktojë llojet e rreziqeve në vendin e punës dhe ambientit të punës që mund të shkaktojnë dëmtime të shëndetit, lëndime në punë, sëmundje profesionale dhe sëmundje lidhur me punën.

Sëmundje profesionale: Identifikim i përkeqësimit të gjendjes fizike apo mendore i cili ndodhë si pasojë e ndonjë aktiviteti të punës dhe/ose situatë që lidhet me punën.

Incident: Ngjarje që rezulton me humbje të kontrollit mbi një rrezik. Incidenti i tillë mund të rezultojë në dëmtim të njerëzve, pronës, makinerive, materiali ose mjedisi.

Matrica e riskut: Vegël e cila përdoret për të ranguar risqet bazuar në nivelin e gjasës/probabilitetit dhe ashpërsisë/pasojës.

Identifikimi i rreziqeve: Procesi i gjetjes, njohjes, identifikimit dhe përshkrimit të rreziqeve.

Eliminimi/zvogëlimi/reduktimi i riskut: Mund të arrihet nëpërmjet largimit të rrezikut ose përzgjedhjes së produkteve apo pajisjeve alternative për të eliminuar riskun. (p.sh ri-dizajnimi i makinerisë, riparimi i pajisjes së dëmtuar, asgjësimi i kimikateve të padëshiruara, etj).

Zëvendësimi i riskut: Zëvendësimi i produktit, pajisjes apo metodologjisë për të reduktuar riskun.

Izolimi i riskut: Mbajtja e rrezikut larg nga vendi i punës (p.sh vendosja e barrierave rreth një rreziku deri sa të reduktohet apo nëse është e mundur eliminohet ai rrezik).

Masat inxhinierike të kontrollit: Modifikimi i vendit të punës, makinerisë apo metodologjisë për të reduktuar kushtet e riskut.

Masat Administrative të kontrollit: Zhvillimi i metodave apo procedurave të punës për të reduktuar riskun.

Pajisjet Personale Mbrojtëse (PPM): Aty ku risku nuk mund të largohet apo të zvogëlohet duhet të përdoren PPM-të gjithmonë. Poashtu, gjatë gjithë procesit të punës duhet të përdoren PPM-të bazuar në specifikimin e tyre dhe punës që bëhet.

Pikat dhe kërkesat nga forma e vlerësimit të riskut dhe plani i masave korrigjuese dhe parandaluese të cilat duhet të plotësohen janë sqaruar si më poshtë.

Forma e vlerësimit të riskut:

Burimi i rrezikut: Paraqet një vendndodhje ose gjendje që mund të shkaktojë një rrezik. Duhet të përcaktohet burimi me potencial për të shkaktuar dëm, lëndim ose efekte të dëmshme në shëndet.

Përshkrimi i rrezikut: Të ofrohet përshkrimi i burimit të identifikuar të rrezikut (si mund të ndodhë dëmtimi/lëndimi).

Ndikimi: Të ofrohet përshkrimi se ku mund të ndodhë dëmi/lëndimi (lëndim trupor, sëmundje) dhe çfarë ndikimi mund të ketë në njerëz, pronë, materiale etj.

Personi/Grupet e afektuara: Të ofrohet informacion për personin/grupet e afektuara (Kush mund të dëmtohet?).

Masat ekzistuese: Të ofrohet përshkrim për masat ekzistuese të kontrollit të cilat tashmë janë në zbatim.

Vlerësimi: Të përcaktohet niveli i gjasës/probabiliteti i dëmit/lëndimit të ndodhur; niveli i ashpërsinë/pasojës së dëmit/lëndimit të ndodhur dhe niveli i riskut duke i shumëzuar nivelin e gjasës/probabilitetit me nivelin e ashpërsisë/pasojës.

Masat korrigjuese dhe parandaluese: Të ofrohet përshkrimi i masave korrigjuese dhe parandaluese të cilat janë të nevojshme për t'u ndërmarrë (çfarë veprime të mëtutjeshme janë të nevojshme?).

Referenca në legjislacionin vendor ose ndërkombëtar: Të ofrohen referencat, lidhjet dhe dokumentet që ndiqen nga njësia nëse janë të aplikueshme.

Matjet: Të ofrohen të dhëna të matjeve të ndryshme (sipas kërkesave ligjore dhe rregulloreve në fuqi).

Data e rishikimit: Të përcaktohet data e rishikimit të vlerësimit të riskut në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Plani i masave korrigjuese dhe parandaluese:

Hierarkia e kontrolleve: Të përcaktohet kontrolli/et më efektive në riskun apo risqet e vlerësuara.

Data e kryerjes së masave korrigjuese dhe parandaluese: Të përcaktohet data e përfundimit të masave korrigjuese dhe parandaluese të cilat janë përcaktuar në formën e vlerësimit të riskut.

Financat e alokuara: Të përcaktohen financat e alokuara për implementimin e masave korrigjuese dhe parandaluese.

Personat përgjegjës: Secila masë duhet të ketë një person përgjegjës dhe datën e caktuar për implementimin e kontrolleve. Kjo siguron që të gjitha masat e kërkuara të sigurohen do të kompletohen dhe dokumentohen.

Risku (R)

Vlerësimi i gjasave/probabilitetit (L – Likelihood/ P – Probability)

Vlerësimi i ashpërsisë/pasojës (S – Severity/ C – Consequence)

$$R = L \times S$$

** Shumëzimi i nivelit të gjasës/probabilitetit (L – nga 1 deri 5) me nivelin e ashpërsisë/pasojës (S – nga 1 deri 5) e përcakton nivelin e riskut. Niveli i riskut klasifikohet në një shkallë nga 1 deri 25.

		ASHPËRSIA / PASOJA				
		1 Minimale	2 Minore	3 Mesatare	4 Madhore	5 Katastrofike
GJASA / PROBABILITETI	1 Rrallë (Shumë pak e mundur)	1 I pranueshëm	2 I tolerueshëm	3 I tolerueshëm	4 I tolerueshëm	5 I tolerueshëm
	2 Nuk ka gjasa (pak e mundur)	2 I tolerueshëm	4 I tolerueshëm	6 Mesatar	8 Mesatar	10 Mesatar
	3 E mundshme	3 I tolerueshëm	6 Mesatar	9 Mesatar	12 Mesatar	15 Madhor
	4 Ka gjasa (shumë e mundur)	4 I tolerueshëm	8 Mesatar	12 Mesatar	16 Madhor	20 Madhor
	5 Pothuajse e sigurt	5 I tolerueshëm	10 Mesatar	15 Madhor	20 Madhor	25 I pa tolerueshëm

Kategoria e gjasave	Përkufizimi
5 Pothuajse e sigurt	Pothuajse e sigurt që ngjarja do të ndodhë gjatë procesit të punës (çdo ditë).
4 Ka gjasa (shumë e mundur)	Ngjarja mund të ndodhë disa herë gjatë procesit të punës (një herë në javë).
3 E mundshme	Ngjarja mund të ndodhë në një të ardhme të afërt (brenda muajit).
2 Nuk ka gjasa (pak e mundur)	Ngjarja ka pak mundësi të ndodhë (mund të ndodhë të paktën një herë në vit).
1 Rrallë (Shumë pak e mundur)	Ngjarja nuk ka gjasa të përsëritet - mund të ndodhë vetëm në rrethana të jashtëzakonshme në > pesë vjet.

Ashpërsia e ndodhjes	Përkufizimi
5 Katastrofike	Vdekje ose humbje e rëndë e përhershme e aftësisë.
4 Madhore	Humbje madhore e rëndë e përhershme ose e përkohshme e aftësisë. Dëmtime madhore që kanë nevojë për trajtim dhe shtrim spitalor që shkaktojnë orë të humbura në procesin e punës (për kohë më të gjatë).
3 Mesatare	Humbje e moderuar e përhershme ose e përkohshme e aftësisë. Dëmtime mesatare që kanë nevojë për trajtim spitalor që shkaktojnë orë të humbura në procesin e punës (për disa ditë).
2 Minore	Dëmtime të vogla/lehta që kanë nevojë për ndihmën e parë dhe trajtim mjekësor, që mund të shkaktojnë orë të humbura në procesin e punës (për pak ditë).
1 Minimale	Pasojë minimale, pa lëndime por mund të ketë nevojë për ndihmën e parë. Personi mund të vazhdojë procesin e punës.

REZULTATET	VEPRIMET E KËRKUARA
<p>(25) Risqet e pa tolerueshme</p>	<p>Këto risqe janë të papranueshme. Janë të nevojshme përmirësime thelbësore në masat e kontrollit të riskut në mënyrë që risku të reduktohet në një nivel të tolerueshëm ose të pranueshëm. Aktiviteti i punës duhet të ndalet derisa të zbatohen kontrollet e riskut që të reduktohet risku në mënyrë që të mos jetë më shumë i lartë. Nëse nuk është e mundur të zvogëlohet risku, puna duhet të mbetet e ndaluar.</p>
<p>(15, 16, 20) Risqet madhore</p>	<p>Duhet të bëhen përpjekje thelbësore për të zvogëluar riskun. Masat e zvogëlimit të riskut duhet të zbatohen brenda një periudhe kohore të përcaktuar dhe mund të jetë e nevojshme të merret në konsideratë kufizimi i aktivitetit, ose të zbatohen masa të përkohshme të kontrollit të riskut, derisa kjo të përfundojë. Burime të konsiderueshme duhet të alokohen për masa shtesë të kontrollit. Duhet të bëhen aranzhime për të siguruar mbajtjen e kontrolleve, veçanërisht nëse nivelet e riskut shoqërohen me pasoja jashtëzakonisht të dëmshme dhe pasoja shumë të dëmshme.</p>
<p>(6, 7, 8, 9, 10, 12) Risqet mesatare</p>	<p>Duhet të merren masa dhe bëhen planifikime nëse risqet mund të ulen, kur është e zbatueshme, në një nivel të tolerueshëm dhe mundësisht në një nivel të pranueshëm, por kostot e masave shtesë të zvogëlimit/reduktimit të riskut duhet të merren parasysh. Masat e zvogëlimit të riskut duhet të zbatohen brenda një periudhe kohore të përcaktuar. Duhet të bëhet planifikim për të siguruar mbajtjen e kontrolleve, veçanërisht nëse zona e niveleve të riskut shoqërohet me pasoja të dëmshme.</p>
<p>(2, 3, 4, 5) Risqet e tolerueshme</p>	<p>Nuk kërkohen kontrolle shtesë nëse ato nuk mund të zbatohen me kosto shumë të ulët (për sa i përket kohës, buxhetit dhe përpjekjeve). Veprimeve për të zvogëluar më tej këto risqe u jepet përparësi e ulët. Duhet të bëhet planifikim për të siguruar mbajtjen e kontrolleve.</p>
<p>(1) Risqet e pranueshme</p>	<p>Këto risqe konsiderohen të pranueshme. Asnjë veprim i mëtejshëm nuk është i nevojshëm përveç sigurimit të mbajtjes së kontrolleve.</p>

FORMA E VLERËSIMIT TË RISKUT

Kompania:		Vendi i punës:	
Departamenti/Njësia:		Numri i punëtorëve:	
Lokacioni:		Nr. i formës së VR:	

Nr.	Burimi i rrezikut	Përshkrimi i rrezikut	Ndikimi	Personi/Grupet e ndikuara	Masat ekzistuese	VLERËSIMI			Masat korrigjuese dhe parandaluese	Referenca në legjislacionin vendor ose ndërkombëtar	Matjet	Data e rishikimit
						Vlerësimi i gjasave (L)	Vlerësimi i ashpërsisë (S)	Niveli i riskut (R)				
1												
2												

PLANI I MASAVE KORRIGJUESE DHE PARANDALUESE

Kompania:		Vendi i punës:	
Departamenti/Njësia:		Numri i punëtorëve:	
Lokacioni:		Nr. i formës së VR:	

Nr.	Burimi i rrezikut	Përshkrimi i rrezikut	Niveli i riskut	Hierarkia e kontrolleve	Masat korrigjuese dhe parandaluese	Data e kryerjes së masave korrigjuese dhe parandaluese	Financat e alokuara	Personat përgjegjës	Rivlerësimi i riskut (L*S=R)			Data e rishikimit
									Vlerësimi i gjasave (L)	Vlerësimi i ashpërsisë (S)	Niveli i riskut (R)	
1												
2												